
UDHËZUES PËR PËRGATITJEN E PLANIT TË SIGURIMIT TË OBJEKTIT

Miratohet
Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ogerta MANASTIRLIU

Sekretari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet
Rustem PACI

Nr. 444/8 Prot

Data 29.03.2019

Udhëzime mbi përmbajtjen e një plani sigurimi

Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë udhëzime për operatorët për përgatitjen e planit të sigurimit të objektit. Ky dokument përfshin sqarime mbi strukturën dhe përmbajtjen në çdo element të tij. Përdoruesit e këtij udhëzimi duhet ti referohen Ligjit Nr. 8025 datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga Rrezatimet Jonizuese", i ndryshuar dhe VKM-së Nr.877, datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë".

Plani i sigurimit dokumenton funksionimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë sistemit të sigurimit të objektit, si dhe zbatimin e elementeve të ndryshme të menaxhimit të sigurimit. Plani i sigurimit mbështet zhvillimin e një kulture të sigurimit dhe janë specifike për një objekt ose operator. Në rastin e një operatori që është përgjegjës për disa objekte, mund të zhvillohen plane individuale të sigurimit për secilin prej objekteve. Që plani i sigurimit të jetë efektiv, duhet të rishikohet, të vlerësohet dhe përditësohet çdo 5 vjet për sa kohë nuk ka ndryshime të cilat çenojnë sigurimin e objektit.

Pasqyra e lëndës

1.	Hyrje	4
1.1	Kërkesat.....	4
1.2	Objekti i planit të sigurimit	4
1.3	Objekti.....	5
1.4	Hartimi dhe përditësimi i planit të sigurimit	5
2.	Përshkrimi i godinës	5
2.1	Vështrim i përgjithshëm	6
2.2	Burimet radioaktive.....	6
2.3	Kategorizimi dhe niveli i sigurimit	6
2.4	Përshkrimi fizik	7
2.5	Përshkrimi i veprimtarisë në objekt	9
3.	Menaxhimi i sigurimit	10
3.1	Rolet dhe përgjegjësitë	10
3.2	Trajnimi	12
3.3	Autorizimi i aksesit	13
3.4	Besueshmëria	13
3.5	Mbrojtja e informacionit	14
3.6	Programi i mirëmbajtjes	16
3.7	Buxheti dhe planifikimi i burimeve financiare dhe njerëzore.....	17
3.8	Vlerësimi dhe efektiviteti	18
4.	Sistemi i sigurimit.....	19
4.1	Informacioni për kërcënime	19
4.2	Metodologjia e vlerësimit të sigurimit	20

4.3	Projektimi i sistemit të sigurimit	21
4.4	Kontrolli i aksesit	22
4.5	Masat e zbulimit, të vlerësimit dhe të vonesave.....	23
5.	Procedurat e sigurimit.....	25
5.1	Veprimtaritë rutinë, jashtë turnit dhe në rast emergjence	25
5.2	Hapja dhe mbyllja e zonave me akses të kufizuar	25
5.3	Kontrolli i çelësit dhe i bravës.....	26
5.4	Verefikimet dhe inventari.....	26
5.5	Pranimi dhe transferimi.....	28
6.	Reagimi.....	28
6.1	Situatat e emergjencës në lidhje me sigurimin.....	28
6.2	Komunikimet.....	29
6.3	Raportimi i situatave emergjente në lidhje me sigurimin	29
6.4	Sigurimi gjatë emergjencave ose rasteve të mundshme të paparashikuara.....	30
6.5	Rritja e nivelit të kërcënimit.....	30
	Referencat	31
	Shtojcat	31

1. Hyrje

Në këtë seksion do të jepen sqarime në lidhje me objektin për të cilin do të hartohet plani i sigurimit. Përshkruani kërkesat rregullatore përkatëse, objektivat, qëllimin dhe procedurat për hartimin, përditësimin e planit të sigurimit.

Shembull teksti

Ky plan sigurimi dokumenton projektimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurimit për [emri i objektit], duke përfshirë të gjithë elementet e menaxhimit të sigurimit.

1.1 Kërkesat

Në këtë seksion duhet të përshkruhen kërkesat rregullatore mbi të cilat bazohet plani i sigurimit.

Tekst shembull

Ky plan sigurimi është përgatitur në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, neni 4, pika 2 si dhe shtojca 1. Të gjitha referencat ndaj pikave në këtë dokument u referohen neneve të rregullores së sipërpërmendur, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe.

1.2 Objekti i planit të sigurimit

Në këtë seksion duhet të përshkruhen objektivat që duhet të përmbushen nga plani i sigurimit.

Tekst shembull

Ky plan sigurimi synon të përmbushë këto objektiva:

- (a) të dokumentojë projektimin dhe operimin e sistemeve të sigurimit.
- (b) të përcaktojë kërkesat bazë për sigurimin e burimeve radioaktive, për të gjitha aktivitetet që lidhen me posedimin, përdorimin, ruajtjen dhe transportin e burimeve radioaktive bazuar në kategorizimin e tyre.
- (c) të demonstrojë pajtueshmëri rregullatore duke specifikuar secilin seksion përkatës, kur përmbushet një kërkesë e veçantë rregullatore.
- (d) të shërbejë si një instrument operacional, i cili përdoret nga strukturat drejtuese dhe stafi për të integruar njerëzit, procedurat dhe pajisjet në një sistem efektiv sigurimi.

1.3 Objekti

Ky seksion përcakton objektin, kufizimet e planit të sigurimit dhe ndërlidhjet e tij me dokumentet ose elementet e tjerë përkatës, siç janë menaxhimi, mbrojtja nga rrezatimi ose reagimi ndaj një emergjence. Referenca duhet të bëhet gjithashtu edhe për fushat ku sigurimi ndërvepron ose ndikon në sistemet e tjera të menaxhimit, veçanërisht me sistemet e sigurimit.

Tekst shembull

Ky plan sigurimi zbatohet për të gjitha veprimet që përfshijnë aktivitetet që lidhen me posedimin, përdorimin, ruajtjen dhe transportin e burimeve radioaktive, kategoria 1, 2 dhe/ose 3, sipas rastit në [emri i vendit]. Masat e sigurimit të kërkuara në planin e sigurimit nuk duhet të bien ndesh me masat e tjera të mbrojtjes dhe sigurisë radiologjike të përfshira në legjislacionin në fuqi.

1.4 Hartimi dhe përditësimi i planit të sigurimit

Ky seksion duhet të përshkruajë procesin e zhvillimit, të miratimit, rishikimit dhe përditësimit të planit të sigurimit çdo 5 vjet dhe sipas nevojës për të trajtuar informacione të reja kërcënuese, ndryshimet e veprimeve në terren ose ndonjë zhvillim tjetër që mund të ketë ndikim mbi efektivitetin e sistemit të sigurimit.

Tekst shembull

Ky plan sigurimi është hartuar në përputhje me VKM Nr. 877, datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, neni 4, pika 2 dhe shtojcën 1, i cili do të rishikohet nga personi përgjegjës dhe miratohet nga administratori i subjektit ose titullari i institucionit me propozimin e personit përgjegjës për sigurimin fizik.

Në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë" neni 6 pika 2/c, nenin 7 pika 2/c dhe nenin 8 , plani i sigurimit do të rishikohet çdo 5 vjet, nëse nuk ka ndryshime, nga personi përgjegjës për sigurimin fizik të burimeve të kategorisë I dhe II dhe III.

Plani i sigurimit do të përditësohet sipas nevojës për të pasqyruar rrethanat që ushtrojnë ndikim mbi efektivitetin e tij të vazhdueshëm, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në rastet kur ndryshon lloji ose vendndodhja e burimit, kur ka ndryshime të veprimtarive në vendin e burimit ose në sistemin e sigurimit, ose kur është e nevojshme për të trajtuar një informacion të ri që përbën kërcënim.

Pas përditësimit dhe miratimit të ndryshimeve në planin e sigurimit, një kopje e këtij plani duhet të vihet në dispozicion ZMR.

2. Përshkrimi i godinës

Ky seksion duhet të përshkruajë burimin(et) radioaktiv(e) dhe vendndodhjen(et) e tyre, të cilat kanë nevojë për sigurim, nivelin e sigurimit të kërkuar, objektin dhe veprimet që ushtrojnë ndikim mbi sigurimin.

Tekst shembull

Seksionet 2.1-2.5 përshkruajnë burimin(et) radioaktiv(e) dhe vendndodhjen(et) e tyre, të cilat kanë nevojë për sigurim, nivelin e sigurimit të kërkuar, objektin dhe veprimet që ushtrojnë ndikim mbi sigurimin.

2.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion duhet të përshkruajë qëllimin ose misionin e objektit dhe organizimin e tij operativ, duke përfshirë llojet e praktikave që përfshijnë burimet radioaktive dhe aparaturat ose pajisjet përkatëse.

Tekst shembull

[Emri i vendit] trajton pacientët me kancer duke ofruar një shumëllojshmëri trajtimesh, duke përfshirë kimioterapinë, teleterapinë, brakiterapinë dhe kirurgjinë, diagnostikon dhe monitoron ecurinë e kancerit të pacientët. Burimet radioaktive të përdorura nga objekti përshkruhen në seksionin 2.2.

2.2 Burimet radioaktive

Ky seksion duhet të përmbajë detaje të burimeve radioaktive që mbulohen nga plani i sigurisë, si edhe pajisjet dhe aparaturat e lidhura, duke përfshirë radionuklidet, aktivitetin dhe datën e referencës, formën kimike dhe fizike, numrin e serisë, markën e pajisjes/aparaturës, modelin dhe prodhuesin.

Shembull tabele

Burimet radioaktive, të cilët janë objekt i këtij plani siguri, përshkruhen si më poshtë vijon:

Aparatura	Numri i serisë i aparaturës	Isotopi	Numri i serisë i burimit	Aktiviteti fillestar (data e referencës)	Kategoria dhe niveli i sigurisë
Njësia e terapisë Theratron Equinox	700xxxxGY901	Cobalt-60	923xxxxxHS65	150 TBq (15 janar 2013)	Kategoria 1 Niveli i sigurisë A
Njësia e brakiterapisë Varian VS2000	5492BJHxxxxx	Iridium-192	3817xxxxX09	.44TBq (31 March 2015)	Kategoria 2 Niveli i sigurisë B

2.3 Kategorizimi dhe niveli i sigurimit

Ky seksion duhet të identifikojë dhe shpjegojë bazën për kategorizimin e burimeve radioaktive mbi bazën e VKM Nr.9 date 7.1.2010 Për miratimin e rregullores “ Mbi kategorizimin e burimeve radioaktive në RSH” si dhe nivelin e sigurimit të lidhur me to sipas nenit 5 të VKM

Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë .

Tekst shembull


Njësia e teleterapisë kobalt-60 caktohet në kategorinë 1/ niveli A i sigurimit dhe njësia e brakiterapisë iridium-192 caktohet në kategorinë 2/niveli B i sigurimit në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, neni 6 dhe 7, si dhe VKM Nr.9 date 7.1.2010 Për miratimin e rregullores “ Mbi kategorizimin e burimeve radioaktive ne RSH", i cili parashikon që të gjitha njësitë teleterapeutike duhet të caktohet në kategorinë 1/niveli A i sigurimit dhe të gjitha njësitë brakiterapi me doze me nivel të lartë deri në të mesëm do të caktohen në kategorinë 2/niveli B i sigurimit.

2.4 Përshkrimi fizik


Ky seksion duhet të përshkruajë karakteristikat fizike të objektit dhe ambientin rrethues, duke përfshirë në planimetri shënime sqaruese dhe fotografi të përshtatshme që paraqesin karakteristikat fizike të objektit dhe datën e realizimit të tyre. Përshkrimi fizik nuk duhet të përfshijë tiparet ose karakteristikat e sigurimit. Sistemi i sigurimit duhet të përshkruhet në seksionin 4.3. Përshkrimet fizike duhet të jenë në formën e planimetrisë dhe përfshijnë:

- a) Vendndodhjen dhe planimetrinë e objektit, duke u përqendruar veçanërisht te zonat e aksesueshme për publikun, rrugët dhe zonat e parkimit, rrugët më të afërta publike, qendrën e monitorimit, ndërtesën dhe perimetrin e truallit, pikat e hyrjes dhe barrierat fizike;
- b) Mjedisin rrethues të objektit, si, për shembull, objektet industriale, tregtare, rezidenciale ose objekte të tjera; tregues të distancave të rajoneve më të afërta të policisë dhe institucioneve ligjzbatues; distancën me ndërtesa dhe rrugë të tjera; dhe karakteristika të tjera të sigurimit, të tilla si objekte të tjera me materiale të rrezikshme.

Përshkrimi fizik i mjedisit rrethues të objektit të paraqitet si më poshtë:



Planimetria e objektit



2.5 Përshkrimi i veprimtarisë në objekt

Ky seksion duhet të japë një përshkrim të veprimtarisë në objekt, duke përfshirë orarin e punës dhe orarin kur nuk punohet me burimet; funksionet dhe numrin e stafit të përfshirë në veprimtarinë në objekt; numrin, funksionin dhe frekuencën tipike të personave të tjerë që e vizitojnë objektin, të tillë si vizitorët, publiku, pacientët, subjektet, ekspertët e jashtëm, personeli i shërbimit ose kontraktuesit, të cilët mund të jenë në objekt gjatë veprimtarive të planifikuara, ose në çdo kohë tjetër.

Tekst shembull

Klinika është e hapur nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 5 të pasdites, nga e hëna deri të premten, me stafin e pranishëm në ambient nga ora 7 paradite deri në orën 6 pasdite. Personeli përfshin drejtorin e klinikës, dy mjekë të tjerë, menaxherin e sigurisë, katër rojet e sigurisë, oficerin e mbrojtjes nga rrezatimi, katër infermierë të tjerë, katër teknikë mjekësorë dhe dy receptionistë. Klinika pret nga 30 deri në 40 pacientë në ditë, duke pasur zakonisht pesë pacientë në objekt në

orë. Objekti mund të vizitohet nga çdo person, por rrallë ndodh që të ketë vizitorë jo të durueshëm.

3. Menaxhimi i sigurimit

Kjo pjesë duhet të përshkruajë masat e menaxhimit të sigurimit në objekt dhe detyrat e veçanta të strukturave drejtuese dhe personelit për të siguruar zbatimin efektiv të tyre.

Seksionet 3.1-3.8 përshkruajnë masat e menaxhimit të sigurimit në objekt si dhe detyrat e veçanta për strukturat drejtuese dhe stafin për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e tyre.

3.1 Rolet dhe përgjegjësitë

Në këtë seksion duhet të dokumentohet caktimi i të gjitha roleve dhe përgjegjëseve në lidhje me sigurimin e burimeve radioaktive, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e:

- drejtuesve, menaxhuesve dhe mbikëqyrësit të objektit;
- personelit që është drejtpërdrejt përgjegjës për sigurimin e burimeve radioaktive;
- personelit që është përgjegjës për çështjet rregullatore, duke përfshirë çdo pozicion të përshkruar nga trupa rregullatore, siç mund të jetë, personi përgjegjës për sigurimin, personeli i sigurimit, këshilltarët, rojet, si dhe çdo pozicion të lidhur me sigurimin, të kërkuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi.

Këto role dhe përgjegjësi duhet të paraqiten në formën e një table.

Përveç kësaj, në këtë seksion duhet të përfshihet një organigramë, që tregon strukturën e personelit me linjat e varësisë dhe të mbikëqyrjes, për të demonstruar se si institucioni dhe përgjegjësitë e sigurimit përshtaten brenda organizimit të përgjithshëm të objektit.

Tekst dhe tabelë shembull


Për të nxitur një kulturë të fortë siguri, çdo person që punon në [emrin e objektit] ka përgjegjësinë të jetë vigjilent ndaj kërcënimeve të mundshme, të kuptojë të gjitha politikat dhe procedurat përkatëse të sigurimit, të raportojë për çdo rrezik të identifikuar të lidhur me sigurimin tek personat përkatës dhe t'u përgjigjet problematikave të sigurimit siç përshkruhet në këtë plan siguri.

Përgjegjësitë specifike të personelit përcaktohen në tabelën e mëposhtme:

Pozicioni	Përgjegjësitë
Drejtori i klinikës	Të miratojë planin e sigurimit. Të përcaktojë politika siguri për [emrin e objektit]. Të sigurojnë që [emrin e objektit] i përmbush të gjitha kërkesat e sigurimit në fuqi.
Personi përgjegjës për	Të përgatisë planin e sigurimit.

Pozicioni	Përgjegjësitë
siguriminë	Të rishikojë dhe të përditësojë periodikisht planin e sigurimit. Të mbikëqyrë projektimin, operimin dhe mirëmbajtjen e planit të sigurimit. Të mbikëqyrë rojet e sigurimit.
Rojet e sigurimit	Të mbajnë në gjendje të mirë pune sistemin qendror të alarmit. Të kryejnë patrullime të rregullta. Të mbledhin reagimet nga incidentet e sigurimit përtej objektit
Oficeri i mbrojtjes nga rrezatimi	Të mbikëqyrë operimin e përditshëm të sistemit të sigurimit. Të mbikëqyrë teknikët dhe infermierët mjekësorë.
Stafi mjekësor	Të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e aplikueshme të sigurimit.
Infermierët	Të kuptojnë dhe të ndjekin procedurat e aplikueshme të sigurimit

Shembull organigrame



3.2 Trajnimi

Personi përgjegjës për sigurimin duhet të ketë trajnimin bazë dhe eksperiencën e nevojshme në lidhje me sigurimin dhe të jetë i njohur nga KMR. Personi përgjegjës për sigurimin ofron instruksione në lidhje me sigurimin për personat që janë pjesë e zbatimit të planit të sigurimit të objektit, sic është e përshtatshme

ky seksion duhet të përshkruajë:

- Instruktazhin që duhet t'i ofrohet çdo individ, duke përfshirë instruktazhin fillestar ose të rifreskuar për çdo pozicion me përgjegjësi të lidhur me sigurimin; instruktazhin për ndërgjegjësimin për sigurimin për të gjithë stafin; si dhe çdo instruktazh tjetër përkatës, në vendin e punës sic përfshihen në procedurat dhe udhëzimet përkatëse.
- Identifikimin e instruktorit dhe frekuencën e instruktazhit.
- Të dhënat përkatëse të instruktazhit të dokumentuar.

Ky informacion mund të paraqitet në formën e një tablele.

Tekst dhe tabelë shembull

Instruktazhi i rregullt i sigurimit kërkohet si më poshtë:

Pozicioni	Lloji i trajnimit/instruktazhit	Shpeshtësia	Ofruesi
I gjithë stafi	Instruktazh bazë për ndërgjegjësimin mbi sigurimin fizik të materialeve radioaktive	Çdo vit	Personi përgjegjës për sigurimin.
Rojet e sigurimit	Instruktazh për sigurimin e godinës	Pas marrjes në punë dhe një herë në vit më pas.	Personi përgjegjës për sigurimin.
Personi përgjegjës për mbrojtjen ndaj rrezatimit	Instruktazh për sigurimin fizik të materialeve radioaktive	Pas marrjes në punë dhe një herë në vit më pas.	Personi përgjegjës për sigurimin.
Infermierët	Instruktazh për sigurimin fizik të materialeve radioaktive	Pas marrjes në punë dhe një herë në vit më pas.	Personi përgjegjës për sigurimin.
Staf mjekësor dhe laborantet	Instruktazh për sigurimin fizik të materialeve radioaktive	Pas marrjes në punë dhe një herë në vit më pas.	Personi përgjegjës për sigurimin.

Të dhënat pas përfundimit të instruktazhit mbahen të dokumentuara në [emri i objektit]

3.3 Autorizimi i aksesit

Ky seksion duhet të përshkruajë procesin e autorizimit të personelit që ka nevojë për akses pa shoqërues në vendndodhjen e burimeve radioaktive, zonat e siguruara dhe/ose në informacion të rezervuar të lidhur me sigurimin për të kryer detyrat e tyre (që mund ose mund të mos lidhen drejtpërdrejt me sigurimin), në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.

Përshkrimi duhet të përfshijë informacion se si:

- a. të identifikohen pozicionet që kërkojnë akses pa shoqërim;
- b. të verifikohet a janë të besueshëm individët që kanë pozicionet e identifikuar (shih seksionin tjetër);
- c. të verifikohet që individët që i kanë pozicionet e identifikuar kanë instruktazhin e nevojshëm (shih seksionin e mëparshëm);
- d. të hiqet akses në kohë për individët që nuk kanë më nevojë për të;
- e. të kryhet rishikimi dhe rivlerësimi periodik për heqjen e aksesit të pa shoqëruar ose kur nuk ka më nevojë për të;
- f. të dokumentohet dhe të përditësohet procesi i dhënies së aksesit pa shoqërues.

Tekst shembull

Aksesi i pashoqëruar në vendet me burime radioaktive, në zonat me sigurim dhe/ose informacion të rezervuar është i kufizuar për ata që kanë nevojë të kenë akses të tillë për të kryer detyrat e tyre, siç konfirmohet nga personi përgjegjës për sigurimin. Aksesi i pashoqëruar është i autorizuar vetëm kur personi përgjegjës i sigurimit verifikon se individi ka kaluar kontrollet përkatëse dhe është i përditësuar sa i përket instruktazhit përkatës.

Individët në pozicionet e mëposhtme kërkojnë akses të pashoqëruar në vendndodhjen(të rishikohtet si term) e burimit radioaktiv:

[lista e pozicioneve]

Individët në pozicionet e mëposhtme kërkojnë akses të pashoqëruar në [emrat e zonave përkatëse me sigurm, nëse janë të ndryshme nga vendi ku ndodhet burimi radioaktiv]:

[lista e pozicioneve]

Individët në pozicionet e mëposhtme kërkojnë akses të pashoqëruar ndaj të gjithë informacionit të rezervuar në lidhje me sigurimin:

[lista e pozicioneve]

Personi përgjegjës i sigurimit do të shqyrtojë dhe rivlerësojë të dhënat e lidhura me instruktazhet dhe do të kryejë kontrollet e dosjeve personale çdo 2 vjet për të siguruar që instruktazhi i stafit të jetë i përditësuar dhe se asnjë staf nuk lejohet të ketë akses pa autorizimin e duhur. Ky rishikim do të zhvillohet gjithashtu në bazë të nevojës kur personeli të ndryshojë vendet e punës, të ketë përgjegjësi të reja pune ose kur t'i ndërpritet punësimi.

Besueshmëria

Ky seksion duhet të përshkruajë procesin e vlerësimit të besueshmërisë së personelit për të përcaktuar nëse atyre duhet t'u jepet akses pa shoqërues në burimet radioaktive, zonat e sigurimit dhe/ose akses në informacionin e rezervuar në lidhje me sigurimin, në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë" neni 6 pika 3 (a) neni 7 pika 3(a) Procesi duhet të dëshmojë gjithashtu kërkesat për rishikim periodik dhe çdo rivlerësim të nevojshëm sipas rrethanave të veçanta.

Përshkrimi duhet:

- a. të identifikojë individët, besueshmëria e të cilëve vlerësohet nga ana e policisë së shtetit bazuar në seksionin e mësipërm për autorizimin për akses;
- b. të identifikojë kërkesat rregullatore në lidhje me besueshmërinë, kushtet për licencim, duke përfshirë dhe amendimet të cilat ndërhyjnë në nivelin e sigurimit ose faktorë të tjerë;
- c. subjekti të paraqesë të dhënat e nevojshme, të përshtatshme sic kërkohet nga autoritetet për të bërë vlerësimin për secilin individ;
- d. të përcaktojë se cilat të dhëna ruhen dhe mbahen konfidenciale si pjesë e vlerësimit të besueshmërisë.

Tekst shembull

Në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë" neni 6 pika 3 (a) neni 7 pika 3(a), besueshmëria e të gjithë personelit të identifikuar në seksionin 3.3, i cili kërkon akses pa shoqërues në burimet radioaktive, zonat e siguruar dhe/ose informacionin e rezervuar, do të verifikohet para miratimit të aksesit në zona të tilla dhe më pas çdo 5 vjet.

[Përshkruani në mënyrë specifike listën e personave me të dhënat përkatëse..]

Regjistrimet e individëve që kërkojnë verifikimin e besueshmërisë dhe rezultatet e këtij verifikimi mbahen në mënyrë konfidenciale për të paktën 5 vjet dhe në përputhje me seksionin 3.5.

3.4 Mbrojtja e informacionit

Mbështetur në mundësinë që ka një informacion i caktuar për të komprometuar sigurimin nëse i bëhet me dije personave të paautorizuar, ky seksion duhet të përshkruajë:

- a. Çfarë informacioni kërkon mbrojtje, siç përcaktohet në VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë" neni 6, pika 4, neni 7 pika 4 dhe neni 8 pika 3 dhe ligjin Nr. 8457 datë 11.02.1999 për klasifikimin e informacionit dhe/ose kërkesat për menaxhimin e objektit, duke përfshirë, si të jetë e përshtatshme:
 - i. vendndodhjen dhe inventarizimin e burimeve radioaktive;
 - ii. autorizimin për akses dhe masat e kontrollit të aksesit;

- iii. përshkrimin e sistemit të sigurimit, pajisjet dhe planimetritë;
- iv. kodet e dyerve ku ruhet lënda radioaktive;
- v. informacionin mbi vlerësimin e kërcënimeve dhe pikave të dobëta;
- vi. mangësitë e përkohshme ose afatgjata në sistemin e sigurimit;
- vii. informacionin për përgjegjësitë e personelit mbi sigurimin;
- viii. mjetet e reagimit ndaj ngjarjeve ose alarmeve;
- ix. datat e planifikuara, rrugët dhe mënyra e transportit ose e transferimit të burimeve radioaktive;
- x. plani dhe procedurat e sigurimit, plani i emergjencave, plani i përgatitjes dhe reagimit ndaj një emergjence radiologjike dhe masat lidhur me të;
- xi. informacionet e privatësisë në lidhje me kontrollet e individëve.

Si identifikohen informacionet e mbrojtura, të tilla si përdorimi i markimeve ose shenjave të tjera që do të sigurojnë që të gjithë përdoruesit e këtij informacioni e dinë që ky informacion duhet të mbrohet?

- b. Format e veçanta të informacionit të mbrojtur si dokumentet në letër. Ku është ruajtur informacioni i mbrojtur dhe kush është përgjegjës për ruajtjen e tij?
- c. Kush ka akses në informacionet e rezervuara dhe si përcaktohet ky akses (p.sh., staf i nevojshëm për të kryer punën, nivelin e duhur të besueshmërisë); shih seksionet 3.3 dhe 3.4.
- d. Çfarë masash mbrojtëse ekzistojnë për të parandaluar aksesin e paautorizuar kur informacioni është duke u përdorur ose duke u ruajtur (p.sh., mbrojtje fizike, enkriptim).
- e. Çfarë kërkesash ekzistojnë për parandalimin e aksesit të paautorizuar kur informacioni i mbrojtur riprodhohet ose transmetohet brenda ose jashtë objektit.
- f. Si shkatërrohet informacioni i mbrojtur për të parandaluar gjurmimin e tij kur ai nuk është më i nevojshëm, duke përfshirë edhe personin e autorizuar për shkatërrimin e informacionit dhe mënyrat e shkatërrimit të informacioneve të ndryshme.

Tekst shembull

Në përputhje me ligjin Nr. 8457 datë 11.02.1999 për klasifikimin e informacionit, *neni 3 i ligjeve/rregulloreve në fuqi* dhe *[kërkesat e menaxhimit të objektit]*, të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me temat e mëposhtme konsiderohen informacione të konfidenciale të lidhura me sigurimin në formë të shkruar.

[lista e temave të aplikueshme, të tilla si ato që specifikohen në pikat a.i-x më sipër]

Një informacion i tillë do të shënohet si *["KONFIDENCIAL" ose më një shënim tjetër të përzgjedhur]*.

Informacioni i mbrojtur do të ruhet në kabinete arkivimi të mbyllura, të cilat do të mbeten të mbyllura gjatë gjithë kohës kur nuk janë në përdorim. Për informacionin e mbrojtur që ruhet në kompjuter, çdo skedar i mbrojtur do të jetë i koduar ose i mbrojtur me fjalëkalim, dhe kompjuteri do të programohet për t'u kyçur automatikisht dhe të kërkojë një fjalëkalim për t'u zhbllokuar. Kompjuteri do të ketë të instaluar versionin më të fundit të softuerit antivirus.

Vetëm ata punonjës personeli që listohen në seksionin 3.3 si persona me akses pa nevojën e shoqërimit në informacionin sensitiv në lidhje me sigurimin do të kenë akses në këtë informacion dhe vetëm për sa kohë që ky informacion u nevojitet për të kryer punën e tyre.

Të gjitha komunikimet elektronike që përmbajnë informacion të mbrojtur do të jenë të koduara ose të mbrojtura me fjalëkalim. Gjatë transportimit të informacionit të mbrojtur në kopje fizike, dokumentet do të kenë një faqe mbuluese, ose do të futen në një zarf ose dosje për të parandaluar situatat kur personat e paautorizuar mund të shohin përmbajtjen.

Informacioni i mbrojtur në format letre do të shkatërrohet kur nuk nevojitet më nga personi i autorizuar. Të gjitha dokumentet në letër do të copëtohen. Informacioni elektronik do të shkatërrohet përmes aplikimit të [emri i softuerit të përzgjedhur për fshirjen permanente të skedarit të zgjedhur].

3.5 Programi i mirëmbajtjes

Në këtë seksion të planit të sigurimit duhet të përshkruhet programi i mirëmbajtjes për pajisjet e sistemit të sigurimit, sipas specifikimeve të VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë për të siguruar operimin e vazhdueshëm dhe të besueshëm.

Tekst shembull

Mirëmbajtja e sistemit të sigurimit ofrohet nga [kontraktuesi që ka instaluar sistemin e sigurisë]. Siç parashikohet në kontratën e mirëmbajtjes, gjatë kohëzgjatjes së kontratës kontraktori kontrollon të gjitha pajisjet për të përcaktuar nëse ato punojnë në baza tremujore dhe zëvendëson çdo pjesë/element që ka defekt.

Kontrollet e mirëmbajtjes së kontraktorëve përfshijnë:

- komponentët elektronikë dhe inspektimet e lidhjes;
- kontrollet dhe zëvendëset e baterisë (nëse është e nevojshme, bateritë zakonisht duhen zëvendësuar pas 1-3 vjetëve në varësi të modelit/llojit);
- kontrollet dhe krahasimet e tensionit;
- pastrimin e komponentëve të përshtatshëm elektronikë (të tilla si lentet e kamerave);
- testimin e performancës së pajisjeve;
- rregullimet e sistemit për performancë maksimale.

Nëse pajisjet dështojnë në mes të vizitave tremujore, kontraktori duhet t'i zëvendësojë ato. Përveç kësaj, kontraktori ofron shërbimet e mëposhtme siç parashikohet në kontratë:

- pjesët zëvendësuese, pa kufizime;
- pjesët e zëvendësimit të përkohshëm, sipas nevojës (pjesët e huadhënësit);
- përgjigjen në objekt brenda 24 orëve nga njoftimi;
- mbështetjen telefonike lokale të pakufizuar;
- vizita të pakufizuara urgjente;
- mirëmbajtjen dhe dokumentacionin e garancisë për objektin.

I gjithë personeli është i detyruar të raportojë problemet e vërejtura me sistemin e sigurisë te [personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar], i cili do të njoftojë kontraktorin.

3.6 Buxheti dhe planifikimi i burimeve financiare dhe njerëzore

Në këtë seksion duhet të përfshihet se si kryhet dhe zbatohet planifikimi i burimeve financiare për sigurimin në nivelin e sistemit të sigurimit dhe se si bëhet raportimi në nivel objektesh, duke përfshirë një përshkrim të mënyrës se si kryhen aktivitetet e mëposhtme:

- Përcaktimi i qëllimeve, strategjive, planeve dhe objektivave për sistemin e sigurimit, të cilat janë në përputhje me politikat e institucionit.
- Përcaktimi i burimeve të nevojshme për të siguruar efektivitetin e sistemit të sigurimit dhe ofrimin e burimeve për të kryer aktivitetet e sistemit të sigurimit, duke përfshirë:
 - burimet njerëzore;
 - trajnimet;
 - kostot operative të sistemit të sigurimit;
 - mirëmbajtjen e pajisjeve; duhet të përfshihet informacion nga seksioni 3.6.
 - të gjitha aktivitetet e tjera të lidhura me sigurimin.
- Ofrimi i burimeve të nevojshme, siç kërkohet nga sistemi i sigurimit.
- Përcaktimi i treguesëve për të siguruar një përdorim efektiv të buxhetit dhe të burimeve.
- Rishikimi i rregullt i burimeve përkundrejt buxhetit dhe parashikimit të burimeve dhe sigurimi i marrjes së masave për të zgjidhur problematikat.

Tekst shembull

[Personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar] përcakton qëllimet, strategjitë, planet dhe objektivat për sistemin e sigurimit. Çdo vit ai ose ajo përcakton burimet e nevojshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen efektive të sistemit të sigurimit, duke përfshirë:

- burimet njerëzore;
- trajnimet;
- shpenzimet operationale të sistemit të sigurimit;
- mirëmbajtjen e pajisjeve;
- të gjitha aktivitetet e tjera që lidhen me sigurimin e burimeve radioaktive.

[*Personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar*] më pas i dorëzojnë një kërkesë [*titullarin/ përfaqësuesin ligjor ose pozicionit tjetër të caktuar*] për burimet e nevojshme financiare dhe burimet e tjera, duke dokumentuar bazën e kësaj kërkesë dhe duke përfshirë metrikën e propozuar për përdorimin efektiv të këtyre burimeve.

[*Titullari/përfaqëuesi ligjor ose pozicioni tjetër i përcaktuar*] vepron mbi këtë kërkesë përmes procesit të rregullt të buxhetimit dhe planifikimit të burimeve të institucionit.

Si pjesë e procesit të vlerësimit të përshkruar në seksionin 3.8, [*Personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i përcaktuara*] rishikon shpenzimet e burimeve kundrejt parashikimeve të buxhetit dhe burimeve si dhe siguron marrjen përsipër të veprimeve për të trajtuar devijimet.

3.7 Vlerësimi dhe efektiviteti

Në këtë seksion duhet të përshkruhet se procesi i verifikimit të pavarur të objektit është në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të sigurimit dhe duhet të vlerësohet efektiviteti i sistemit të sigurimit për të identifikuar ndonjë dobësi që duhet korrigjuar dhe çdo mundësi për përmirësim të vazhdueshëm, duke përfshirë rregullimet për testimin e performancës, në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë [*nenin e ligjeve/rregulloreve në fuqi*].

Tekst shembull

[*Personi përgjegjës për sigurimin ose pozita tjetër e përcaktuar*] zhvillon dhe zbaton një vlerësim vjetor të sigurimit lidhur me pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe/ose rregullatore në fuqi dhe me efektivitetin në mbrojtjen e burimeve radioaktive të objektit.

Qëllimi i vlerësimit përfshin si menaxhimin e sigurimin, ashtu edhe sistemin e sigurimit. Sipas rastit, vlerësimi i vitit mund të theksojë përputhjen me rregulloret specifike ose performancën e elementeve të veçanta të sistemit të sigurimit, ose temat e menaxhimit. Metodatat e vlerësimit përfshijnë:

- rishikimin e dokumenteve (shembull: rishikimin e regjistrave të kontabilitetit, procedurat e kontrollit të aksesit, të dhënat e trajnimit);
- intervistat (shembull: bërja e pyetjeve për përgjegjësin e sigurimit ndaj rrezatimit);
- vëzhgimin (shembull: të parit e personelit që hyn në zonën e siguruar);
- testimin e performancës (shembull: të pajisjeve, të personelit ose të procedurave);
- Metodatat e vlerësimit të sistemit të sigurimit, të përshkruara në seksionin 4.2.

Pas përfundimit të vlerësimit [*Personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar*] përpilon rezultatet dhe përgatit një raport vlerësimi që përfshin, si në vijim:

- objektin dhe llojin e vlerësimit;
- temat e vlerësuar;
- kërkesat dhe masat e efektivitetit ose praktikatat më të mira të zbatueshme për secilën temë;
- metodatat për vlerësim në lidhje me secilën temë;

- përfundimet në lidhje me secilën temë, me referencë specifike për bazën për secilin përfundim;
- rekomandime për veprimet pasuese, duke përfshirë:
 - çdo rezultat që duhet të raportohet menjëherë tek trupa rregullatore;
 - veprime të tjera që duhet të ndërmerren;
 - identifikimin e personit përgjegjës për çdo veprim;
 - kur duhet të kryhet çdo veprim;
 - marrjen e përgjegjësisë për konfirmimin dhe dokumentimin e çdo veprimi.

[Personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar] i shqyrton rezultatet me [titullarin/përfaqësuesin ligjor ose pozicionin tjetër të caktuar] dhe rregullon çfarëdo veprimi të nevojshëm pasues sipas udhëzimeve.

4. Sistemi i sigurimit

Në këtë seksion duhet të përshkruhet se si hartohet dhe zbatohet plani për sistemin aktual të sigurimit për të mbrojtur burimet radioaktive të objektit sipas VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë".

Tekst shembull

Seksionet 4.1-4.5 përshkruajnë sistemin e sigurimit të projektuar dhe të zbatuar në [emri i objektit] për të mbrojtur burimet radioaktive të objektit në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë [titullin e ligjeve/rregulloreve në fuqi për sigurimin e burimeve radioaktive].

4.1 Informacioni për kërcënime

Të gjitha masat për sigurimin e burimeve radioaktive zbatohen në kushtet e një niveli mesatar(portokalli) të kërcënimit në vendin tonë. Me rritjen e shkallës së kërcënimit në nivel kombëtar ose lokal, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me institucionet e linjave përkatëse përcakton masat shtesë për përdoruesit e burimeve radioaktive sic ato e shohin të nevojshme. Këto masa janë të detyrueshme për zbatim nga ana e përdoruesve.

Ky seksion duhet të japë po ashtu informacion lidhur me personin përgjegjës për ta marrë këtë informacion kërcënues, duke përfshirë njoftimet nga trupa rregullatore, ose të tjera palë, të një kërcënimi specifik, ose të një kërcënimi në rritje, dhe mënyrën se si ky informacion ndahet siç duhet me personelin në objekt, të cilët duhet ta dinë këtë lloj informacioni.(titullari/përfaqësuesi ligjor i kompanise dhe Personi përgjegjës për sigurimin)

Tekst shembull

[Emri i trupës rregullatore] ofron informacion të përgjithshëm për [emrin e objektit] sa i përket natyrës së kërcënimit, kundër të cilit duhet të ofrojë mbrojtje sistemi i sigurimit. [Emri i trupës rregullatore] njofton po ashtu objektin në rast se vihet në dijeni për një kërcënim specifik ose të rritur. Ky informacion i ofrohet [Personit përgjegjës për sigurimin ose një pozicioni tjetër të caktuar] përmes një email-i të sigurt, ose një personi në një takim të posaçëm. [Personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar] e ndan këtë informacion përmes mjeteve

të sigurta (zakonsiht në një takim ballë për ballë) me stafin e objektit, të cilët janë të autorizuar të marrin informacione sensitive dhe të cilëve u duhet ta marrin këtë informacion për këtë arsye.

[Emri i trupës rregullatore] e ka këshilluar [emrin e objektit] se gjatë projektimit të sistemit të sigurimit, sulmuesit e jashtëm të mundshëm përbëhen nga dy individët, të armatosur me pushkë joautomatike, të pajisur me vegla pune dore, pa lëndë eksplozive dhe pa aftësi të posaçme për ta hequr burimin radioaktiv nga aparati; armiku i brendshëm i mundshëm përbëhet nga një punonjës i cili nuk ka akses të autorizuar për informacione sensitive, i/e cila vepron si bashkëpunëtor me keqbërësit.

4.2 Metodologjia e vlerësimit të sigurimit

Vlerësimi i sigurimit të objektit, si dhe rivlerësimi i tij derisa të përmbushë qëllimet realizohet nga personi përgjegjës për sigurimin e objektit dhe më tej vlerësohet nga trupa rregullatore. Në këtë seksion duhet të përshkruhet procesi ose metodologjia e përdorur për të vlerësuar planin e sigurimit dhe për të vlerësuar pikat e dobëta të tij, duke marrë parasysh informacionin e ofruar për kërcënimin. Përshkrimi duhet të japë rezultatet e vlerësimit fillestar të sigurimit si kontribut për projektimin e sistemit të sigurimit (shih seksionin e mëparshëm), përditësimet periodike si pjesë e rishikimit të planit të sigurimit dhe kërkesat rregullatore, si dhe të reflektojë modifikimet në objekt, ose zhvillime të tjera të cilat mund të ushtrojnë ndikim mbi performancën e sistemit të sigurimit ose pikave të tij të dobëta.

Tekst shembull

Për projektimin e sistemit të sigurimit për çdo burim radioaktiv në objekt, përdoren dy metoda vlerësimi. Së pari, subjekti rishikon kërkesat për funksionimin e sigurimit të detektimit dhe vlerësimit, vonesave dhe reagimit sipas VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë. Mbështetur në këto kërkesa, subjekti zhvillon një projekt fillestar të sistemit të sigurimit.. Së dyti, subjekti kryen një analizë cilësore të pikave të dobëta për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të sigurimit në mënyrë që të përmbushen objektivat e performancës, të specifikuara në rregulloren e cituar më sipër, kundrejt kërcënimit të përshkruar në seksionin 4.1. Analiza përfshin hapat e mëposhtme:

1. Identifikimin e rrugës për në vendndodhjen e burimit , e cila do të ishte rruga më e favorshme për keqbërësit (pika më e dobët).
2. Analizimin e sistemit fillestar të sigurimit, duke përdorur parimin e “zbulimit në kohë” për të vlerësuar kohën e reagimit.
3. Shqyrtimin e përshtatshmërisë së reagimit në raport me rrezikun e mundshëm.
4. Vlerësimin e efektivitetit të përgjithshëm të sistemit.
5. Në rast se efektiviteti i sistemit nuk i përmbush qëllimet e përcaktuara të performancës, duhet të bëhet riprojektimi dhe rivlerësimi i sistemit deri sa ai t'i përmbushë qëllimet.

Rezultati i kësaj analize është sistemi i sigurimit i përshkruar në seksionin 4.3. Këto metoda aplikohen po ashtu edhe në realizimin e vlerësimit për përputhshmëri dhe efektivitet të përshkruar në seksionin 3.8 dhe në trajtimin e informacionit të ri kërcënues, ndryshimet e

aktiviteteve në objekt, ose çdo zhvillim tjetër që mund të cenojë performancën ose pikat e dobëta të sistemit të sigurimit. Me rritjen e shkallës së kërcënimit mbi nivelin e përgjithshëm të sigurimit që është zbatuar në objekt roli kryesor për përcaktimin e masave shtesë mbi sigurimin i mbetet policisë së shtetit e cila njofton subjektet bazuar në shkallën e kërcënimit për masat shtesë që duhet të zbatojnë subjektet me qëllim sigurimin e burimeve radioaktive.

4.3 Projektimi i sistemit të sigurimit

Në këtë pjesë duhet të përshkruhet se si është projektuar dhe integruar sistemi i sigurimit në nivel objekti për të siguruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes duke marrë parasysh qasjen e shkallëzuar dhe parimet e mbrojtjes në thellësi dhe mbrojtjes së ekuilibruar. Ky përshkrim duhet të tregojë se si secila prej zonave të siguruara dhe burimet përkatëse radioaktive mbrohen nëpërmjet masave për zbulimin, vonesën dhe të reagimit në mënyrë të integruar dhe të ekuilibruar. Ky përshkrim duhet të përfshijë identifikimin e llojeve të pajisjeve, sistemeve të instaluar dhe vendndodhjen e tyre.

Tekst shembull dhe skicë

Projektimi i sistemit të sigurimit për njësinë e teleterapisë dhe njësinë e brakiterapisë jepen më poshtë. Detajet e masave të kontrollit të aksesit, të zbulimit, të vonesës dhe të reagimit, si dhe procedurat e sigurimit përshkruhen përkatësisht në seksionet 4.4, 4.5 dhe 5. (Të përcaktohen distancat)

Celës magnetik i balancuar



Video kamër ose regjistruar video digjital



Sensor lëvizjeje



Celës elektromagnetik



Sensor për thyerjen e xhamit



Apart për identifikimin e numrit personal, ose lexues karte



celës i fiksuar alarmi



Paisje për fiksimin




Celës i lëvizshëm alarmi



Radio





4.4 Kontrolli i aksesit

Ky seksion duhet të përshkruajë masat fizike për kontrollin e aksesit në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, duke treguar në veçanti:

- Si kontrollohet fizikisht personeli në çdo pikë kontrolli për të kufizuar hyrjen vetëm te personat e autorizuar, sipas procedurës së autorizimit të aksesit, dhe për të parandaluar hyrjen e paautorizuar.
- Mënyrën specifike të përdorur për të vërtetuar identitetin e personave të autorizuar, të tilla si kartën kryesore, numrin personal të identifikimit, pajisjen biometrike ose një kombinim të tyre.
- Procedurat që duhet të ndiqen nga personat e autorizuar për të hyrë në një zonë me akses të kufizuar, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, aplikimin e rregullit me dy persona. Mënyrën e shoqërimit të personave që nuk kanë akses , në zonat me akses të kufizuar.)

Tekst shembull

Në përputhje me VKM Nr.877, datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë [neni i ligjeve/rregulloreve në fuqi] janë përcaktuar masat e mëposhtme të kontrollit të aksesit.

Njësia e teleterapisë

Kur mbaron orari i punës, dera e dhomës së trajtimit me teleterapi mbyllet me kyç elektromagnetik, duke kërkuar si përdorimin e kartës së afërsisë, ashtu dhe një numër identifikimi personal për të fituar akses. Për të zbuluar hyrjen e paautorizuar, aktivizohet një çelës magnetik i balancuar në derë dhe një sensor i brendshëm për lëvizjen.

Gjatë orarit të punës dera e dhomës së trajtimit me teleterapi rri e hapur, por nën vëzhgimin e vazhdueshëm të personelit të trajnuar, i cili është i pajisur me një buton lëvizjeje. Pacientët dhe personat e tjerë të paautorizuar mund të hyjnë vetëm nëse shoqërohen nga personeli që ka autorizim për t'u futur në dhomë.

Njësia e brakiterapisë

Kur mbaron orari i punës, dera e dhomës së trajtimit me brakiterapi mbyllet me kyç elektromagnetik, duke kërkuar si përdorimin e kartës së afërsisë, ashtu dhe një numër identifikimi personal për të fituar akses. Për të zbuluar hyrjen e paautorizuar, aktivizohet një çelës magnetik i balancuar në derë dhe një sensor i brendshëm për lëvizjen.

Gjatë orarit të punës dera e dhomës së trajtimit me brakiterapi rri e hapur, por nën vëzhgimin e vazhdueshëm të personelit të trajnuar, i cili është i pajisur me një buton lëvizjeje. Pacientët dhe personat e tjerë të paautorizuar mund të hyjnë vetëm nëse shoqërohen nga personeli që ka autorizim për akses për t'u futur në dhomë.

4.5 Masat e zbulimit, të vlerësimit dhe të vonesave

Për secilën nga zonat me akses të kufizuar, përshkruani:

- a. mjetet e zbulimit, duke përfshirë sistemet e zbulimit të ndërhyrjeve, vëzhgimin nga personeli i objektit;
- b. metodën e vlerësimit, duke përfshirë njerëzit dhe pajisjet që do të përdoren për të kryerë vlerësimin;
- c. masat përkatëse për vonesat, të përdorura për të rritur kohën e veprimit të keqbërësit në raport me kohën e përgjigjes.

Tekst shembull

Sistemet e sigurimit përbëhen nga masat e mëposhtme të zbulimit, të vlerësimit dhe të vonesës.

Njësia e teleterapisë

Zbulimi. Pas mbarimit të orarit të punës, zbulimi i aksesit të paautorizuar në dhomën e trajtimit me teleterapi sigurohet nga një çelës magnetik i balancuar në derë dhe një sensor lëvizjeje me teknologji të dyfishtë të vendosur brenda dhomës së trajtimit. Gjatë orarit të punës zbulimi sigurohet nëpërmjet vëzhgimit të vazhdueshëm nga një staf i trajnuar, i pajisur me një buton lëvizës dhe një transmetues radioje. Në dhomën e trajtimit është instaluar gjithashtu edhe një buton fiks alarmi.

Vlerësimi. Pas orarit të punës alarmet nga sensorët komunikohen në stacionin e monitorimit të alarmit të [*emri i vendndodhjes*], i cili ndodhet në [*emrin e objektit*] rajonin e policisë X. Rojet e sigurisë në stacionin e monitorimit të alarmit shikojnë imazhet video nga kamerat e vendosura në dhomën e trajtimit për të përcaktuar nëse është i pranishëm një njeri që do të futet në ambientet e brendshme. Nëse po, roja e sigurisë lajmëron policinë lokale. Gjatë orarit të punës vlerësimi bëhet nga stafi, njëkohësisht me zbulimin përmes vëzhgimit. Nëse mund të jetë i pranishëm një person që dëshiron të futet në ambientet e brendshme, anëtarët e stafit lajmërojnë policinë me anë të pulsanit të lëvizshëm, radios, ose një butoni fiks alarmi.

Vonesa. Mjetet e vonësës përfshijnë derën e blinduar në dhomën e trajtimit, të pajisur me një çelës elektromagnetik, fiksimin e njësive së teleterapisë në dysHEME dhe mënyrën e vendosjes së vetë njësive së teleterapisë (e cila duhet të jetë pjesërisht e çmontuar për të hequr burimin radioaktiv).

Njësia e brakiterapisë

Zbulimi. Pas mbarimit të orarit të punës, zbulimi i aksesit të paautorizuar në dhomën e trajtimit me teleterapi sigurohet nga një çelës magnetik i balancuar në derë dhe një sensor lëvizjeje me teknologji të dyfishtë të vendosur brenda dhomës së trajtimit. Gjatë orarit të punës zbulimi sigurohet nëpërmjet vëzhgimit të vazhdueshëm nga një staf i trajnuar, i pajisur me një buton lëvizës dhe një transmetues radioje. Në dhomën e trajtimit është instaluar gjithashtu edhe një buton fiks alarmi.

Vlerësimi. Pas orarit të punës alarmet nga sensorët komunikohen në stacionin e monitorimit të alarmit të [*emri i vendndodhjes*], i cili ndodhet në [*emrin e objektit*] në rajonin e policisë së Qytetit të Studentëve. Rojet e sigurisë në stacionin e monitorimit të alarmit shikojnë imazhet video nga kamerat e vendosura në dhomën e trajtimit për të përcaktuar nëse është i pranishëm një njeri që do të futet në ambientet e brendshme. Nëse po, roja e sigurisë lajmëron policinë lokale. Gjatë orarit të punës vlerësimi bëhet nga stafi, njëkohësisht me zbulimin përmes vëzhgimit. Nëse mund të jetë i pranishëm një person që dëshiron të futet në ambientet e brendshme, anëtarët e stafit lajmërojnë policinë me anë të pulsanit të lëvizshëm, radios, ose një butoni fiks alarmi.

Vonesa. Mjetet e vonësës përfshijnë derën e blinduar dhe të përforcuar në dhomën e trajtimit, të pajisur me një çelës elektromagnetik dhe fiksimin e njësive së brakiterapisë në dysHEME.

5. Procedurat e sigurimit

Në këtë seksion duhet të përshkruhen procedurat me shkrim që u japin udhëzime personelit përgjegjës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e masave të sigurimit. Procedurat duhet të jenë dokumente të pavarura dhe mund të përfshihen si shtojca të planit të sigurimit.

Tekst shembull

Seksionet 5.1-5.5 përmbledhin procedurat që përdoren nga stafi për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurimit. Procedurat e plota me shkrim jepen në dokumente të veçanta, të cilat i jepen stafit të caktuar.

5.1 Veprimtaritë rutinë, jashtë turnit dhe në rast emergjence

Në këtë seksion duhet të përshkruhet se si personeli i caktuar, si, për shembull, stafi ose kontraktorët, menaxhojnë sistemet e sigurimit dhe zbatojnë detyrimet e lidhura me sigurimin në periudhën:

- Gjatë orarit të punës
- pas orarit të punës (pas turnit dhe kur stafi nuk është zakonisht i pranishëm, përgjithësisht gjatë netëve, fundjavave dhe gjatë pushimeve)
- gjatë veprimtaritë në raste emergjence.

Tekst shembull

Stafi i caktuar ka përgjegjësi të ndryshme dhe ndjek procedura të ndryshme gjatë orarit të punës, pas orarit të punës dhe gjatë aktiviteteve emergjente. Gjatë orarit të punës sensorët janë të çaktivizuar dhe përgjegjësinë kryesore për zbulimin dhe vlerësimin e pranishmësisë së personave ndërhyrës dhe njoftimin për përgjigje e ka stafi mjekësor. Pas orarit të punës aktivizohen sensorët dhe stafi i monitorimit të alarmeve vlerëson shkaktarin e alarmit dhe bën njoftimin për të marrë përgjigje. Gjatë operacioneve emergjente i gjithë personeli i pranishëm mund të thirret për të ndihmuar derisa të rikthehen veprimtaritë normale.

5.2 Hapja dhe mbyllja e zonave me akses të kufizuar

Në këtë seksion duhet të përshkruhen procedurat për hapjen dhe mbylljen e secilës zonë me akses të kufizuar ku gjendet burimi radioaktiv, veçanërisht aktivitete, të tilla si: hapja dhe mbyllja e dyerve dhe e barrierave të tjera, si dhe komunikimet me stacionin e monitorimit të alarmit për çaktivizimin dhe aktivizimin e sistemeve të zbulimit. Procedurat duhet të identifikojnë se kush brenda institucionit është përgjegjës për hapjen dhe mbylljen e këtyre zonave dhe duhet të përfshijnë veprime për të vërtetuar sigurimin e duhur të mekanizmave të tjerë të vonesës (p.sh. kafazë).

Tekst shembull

Në fillim të çdo dite pune hapja dyerve të dhomave të trajtimit me teleterapi dhe brakiterapi dhe çaktivizimi i sensorëve bëhet nga dy roje sigurimi. Më pas, ata kryejnë ekzaminimin e dhomës së trajtimit dhe të pajisjes për të verifikuar mungesën e shenjave ndërhyrëse, ose preken e

mekanizmave të vonesës ose të pajisjes, konfirmojnë që personeli mjekësor përgjegjës i ngarkuar me kontrollin e aksesit gjatë orarit të punës është pajisur siç duhet me pajisjet e nevojshme të komunikimit dhe i raportojnë këto veprime në stacionin e monitorimit të alarmit.

Në fund të çdo dite pune, dy roje sigurimi konfirmojnë që stafi mjekësor nuk ka më nevojë të hyjë në dhomën e trajtimit dhe verifikojnë sigurimin e duhur të pajisjes. Më pas ata aktivizojnë sensorët, mbyllin dyert e dhomës së trajtimit dhe i raportojnë këto veprime në stacionin e monitorimit të alarmit.

5.3 Kontrolli i çelësit dhe i bravës

Përshkruani procedurat e përdorura për kontrollin e të gjithë çelësave, bravave, kombinimeve, fjalëkalimeve dhe masave përkatëse të cilat përdoren për të kontrolluar aksesin në zonat e siguruara dhe sistemet e sigurimit. Procedurat duhet të identifikojnë se kush është përgjegjës për ndryshimin e masave të kontrollit të aksesit, si edhe kushtet specifike që kërkojnë ndryshimin e tyre, siç është komprometimi i një kombinimi ose fjalëkalimi, humbja e një çelësi sigurimi ose ndërprerja e aksesit të një anëtari.

Tekst shembull

Pas vërtetimit nga ana e [*personit përgjegjës për sigurimin ose pozicion tjetër i përcaktuar*] se një anëtar i stafit është i autorizuar për akses pa shoqërues në vendet ku gjenden burimet radioaktive dhe/ose zonat e siguruara, [*personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i përcaktuar*] i lëshon anëtarit të stafit një kartë hyrjeje dhe numrin personal identifikues (PIN-in). Të gjitha PIN-et e përdoruesve do të riprogramohen çdo 12 muaj ose më shpesh në rast të një komprometimi kombinimi ose PIN-eve, në rastin e humbjes së një çelësi sigurimi, ose ndërprerjes së aksesit të një anëtari të stafit.

[*personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar*] është përgjegjës për mbledhjen e kartave dhe çelësave të aksesit kur ndryshon autorizimi i hyrjes së një anëtari të stafit. Përveç kësaj, karta e aksesit dhe PIN-i kërkojnë që [*personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar*] të verifikojnë çdo 6 muaj që çdo përdorues kualifikohet për vazhdim aksesi në vend. Në rast se aksesi i vazhdueshëm nuk verifikohet brenda 6 muajve, sistemi programohet në mënyrë të tillë që të mohojë aksesin e personelit derisa të konfirmohet autorizimi për akses.

5.4 Kontabiliteti dhe inventari

Në këtë seksion duhet të përshkruhet se si bëhet verifikimi periodik i burimeve radioaktive, siç kërkohet në VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë [*neni i ligjeve/rregulloreve në fuqi*], duke përfshirë:

- a. metodën e përdorur të verifikimit, siç është kontrolli fizik, monitorimi në distancë me video, kontrolli i vulave,ipajisjeve ose matjet e rrezatimit.;
- b. të dhënat e mbledhura, duke treguar rezultatet e çdo kontrolli, kur, nga kush, dhe me çfarë metode;
- c. kërkesat për veprime korrigjuese dhe raportimin kur konstatohet mungesa e burimit radioaktiv.

Në këtë seksion duhet të përshkruhet gjithashtu edhe se si bëhet inventari i burimeve radioaktive dhe si realizohet mirëmbajtja e tij, siç kërkohet nga VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë neni 11, pika dh dhe e, duke përfshirë:

1. vendndodhjen e burimeve;
2. radionuklidet;
3. radioaktivitetin në një datë të caktuar;
4. numrin serial ose identifikuesin unik;
5. formën kimike dhe fizike;
6. historikun e përdorimit të burimeve radioaktive dhe çdo lëvizje të brendshme, sipas rastit;
7. marrjen, transferimin ose asgjësimin e burimeve radioaktive;
8. informacione të tjera, sipas rastit, për të mundësuar identifikimin dhe gjurmueshmërinë e burimeve radioaktive ;
9. njoftimin e trupës rregullatore lidhur me ndryshimet në inventar brenda periudhës së përshkruar;
10. raportimin e inventarit tek organizmi rregullator në intervalet e përcaktuara për të verifikuar që ai është i plotë dhe i saktë.

Tekst shembull

Në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, [emri i objektit] kryen verifikim periodik për burimet radioaktive, krijon dhe mirëmban një inventar të burimeve radioaktive si më poshtë.

[Personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar], verifikon praninë e burimit të teleterapisë çdo ditë dhe burimet e brakiterapisë çdo javë. Ky verifikim kryhet përmes ekzaminimit të pajisjes për të konfirmuar mungesën e ndërhyrjes dhe rishikimin e matjeve të monitorimit të rrezatimit. [personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar] e shënon rezultatin e çdo kontrolli në një regjistër kontabiliteti të burimit menjëherë pas kryerjes së verifikimit. Nëse prezenca e burimit radioaktiv nuk mund të verifikohet, [personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar] njofton menjëherë [titullarin/ ose përfaqësuesin ligjor/ ose pozicionin tjetër të caktuar], [organin rregullator] dhe [policinë lokale ose një organ tjetër përgjegjës].

Inventari. [personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar] mban një inventar të burimeve radioaktive në [emri i objektit], i cili përmban informacionin e mëposhtëm për secilin burim radioaktiv:

- Vendndodhjen e burimit;
- Radionuklidet;
- Radioaktivitetin në një datë të caktuar;
- Numrin serial ose numrin identifikuesin unik;
- Formën kimike dhe fizike;
- Historikun e përdorimit të burimeve radioaktive dhe çdo lëvizje të brendshme, sipas rastit;

- Datën dhe origjinën ose destinacionin e pranimit, të transferimit ose deponimit të burimit radioaktiv.

[*Personi përgjegjës për sigurimin ose pozicioni tjetër i caktuar*] verifikon saktësinë e inventarit çdo vit dhe rregullon informacionin për çdo burim radioaktiv brenda 30 ditësh nga çdo ndryshim.

5.5 Pranimi dhe transferimi

Në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, në këtë seksion duhet të përshkruhen procedurat për të siguruar që subjekti kujdeset për sigurimin dhe kontrollin e cdo burimi radioaktiv kur pranohet në objekt. Të përcaktohen procedurat për të siguruar që në objekt janë marrë masat e nevojshme që burimet radioaktive ti jepen vetëm subjekteve të autorizuar nga organi kompetent.

Tekst shembull

Kur merret ose transferohet një burim radioaktiv, [*personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar*] cakton masa kompensuese të sigurimit, të përshtatshme për kategorinë e burimit. Masat e tilla mund të përfshijnë punësimin e rojeve shtesë të sigurimit për të mbrojtur burimin, ndërkohë që ai është jashtë objektit të siguruar ose në një automjet transporti, dhe koordinimin me policinë lokale, në mënyrë që ata të jenë në dijeni se po bëhet transferimi. Kur transferojmë një burim në një subjekt të jashtëm, [titullari ose përfaqësuesi ligjor ose *një person tjetër i caktuar*] së pari do të bëjë verifikimin me [*trupën rregullatore*] për të vërtetuar se njësia ka autorizimin e nevojshëm për të trajtuar këtë burim.

6. Reagimi

Në këtë seksion duhet të përshkruhen masat reaguese për situatat e emergjencës në lidhje me sigurimin.

Tekst shembull

Seksionet 6.1-6.5 përshkruajnë masat reaguese për situatat e emergjencës në lidhje me sigurimin

6.1 Situatat e emergjencës në lidhje me sigurimin

Në këtë seksion duhet të përshkruhen masat e marra nga subjekti me autoritetet lokale të zbatimit të ligjit ose autoritete të tjera përgjegjëse, për të reaguar në një situatë emergjente lidhur me sigurimin duke përfshirë tentativat për vjedhje, vjedhjet e realizuara, zhvendosjen e paautorizuar ose sabotimin e një burimi ose pajisjeje që përmban burim radioaktiv.

Tekst shembull

[*personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar*] ka përgjegjësinë e përgjithshme për të bërë rregullime për përgjigjen ndaj një ngjarjeje sigurie duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Kontakton me [autoriteti i lokal i zbatimit të ligjit, ose autoriteti tjetër përgjegjës i përgjigjes] dhe organizon një vizitë në [emri i objektit] për t'u njohur me burimet dhe pajisjet radioaktive në vend, sistemin e sigurimit dhe masat e menaxhimit të sigurimit.
- Konfirmon mjetet me anë të së cilave bëhet njoftimi i [autoriteti lokal i zbatimit të ligjit ose një organ tjetër përgjegjës i caktuar] pas zbulimit dhe vlerësimit të një alarmi.
- Në koordinim me [trupën rregullatore], diskutohet me [autoritetin lokal të zbatimit të ligjit ose një autoritet tjetër përgjegjës për përgjigje] mbi kërcënimin për të cilin duhet të jenë të përgatitur t'i përgjigjen këto organe.
- Merr nga [autoriteti lokal i zbatimit të ligjit ose një autoritet tjetër përgjegjës për përgjigjen] kohën e llogaritur për përgjigje dhe e modifikon sistemin e sigurimit sipas nevojës për të krijuar vonesë të mjaftueshme për të mundësuar një reagim në kohë.
- Arrin marrëveshje me [autoritetet lokale të zbatimit të ligjit ose një autoritet tjetër përgjegjës për reagim] për çdo veprim specifik që duhet marrë nga stafi në objekt për të lehtësuar përgjigjen.
- Organizon ushtrime/ testime vjetore të këtyre organizimeve për t'u përgjigjur ngjarjeve të mundshme të sigurisë.

6.2 Komunikimet

Në këtë seksion duhet të përshkruhen metodat e komunikimit që do të përdoren për të ndërhyre në një situatë emergjente lidhur me sigurimin.

Tekst shembull

[Emri i objektit] përdor mjetet e mëposhtme të komunikimit për t'u ndërlidhur me [autoritetin lokal të zbatimit të ligjit ose një autoritet tjetër përgjegjës të caktuar]:

- butonat e lëvizshëm të alarmit;
- butonat fiks të alarmit;
- radiot;
- telefonat fiks;
- telefonat celularë.

Të gjitha këto janë programuar për të mundësuar komunikim të menjëhershëm me [autoritetin lokal të zbatimit të ligjit ose me një autoritet tjetër përgjegjës të caktuar] për t'i njoftuar një ngjarje siguri bërthamore që ose është duke ndodhur ose mund të ndodhë në objekt.

6.3 Raportimi i situatave emergjente në lidhje me sigurimin

Në këtë seksion duhet të përshkruhet mënyra e raportimit të situatave emergjente në lidhje me sigurimin tek trupa rregullatore dhe autoritetet lokale dhe qendrore. Përshkruani mënyrën sesi duhen dokumentuar ngjarjet, kush është përgjegjës për të dokumentuar ngjarjen dhe kërkesat e mëvonshme të raportimit (p.sh. raportimi tek trupa rregullatore). Specifikoni se si bëhet rishikimi

i masave reaguese pas një ngjarjeje të tillë për të vlerësuar efektivitetin e planit të sigurimit dhe për të identifikuar veprimet e nevojshme korrigjuese.

Tekst shembull

Pas një ngjarje të lidhur me sigurimin, *[personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar]* është përgjegjës për hartimin e një raporti mbi çfarë ka ndodhur. Raporti i jepet *[trupës rregullatore]* brenda *[numri i ditëve të kërkuara nga organi rregullator]* ditësh nga incidenti, siç kërkohet nga *[neni i ligjeve/rregulloreve në fuqi]*. *[personi përgjegjës për sigurimin ose një pozicion tjetër i caktuar]* do të punojnë së bashku me kompaninë e sigurimit, sipas nevojës, për të kuptuar se si ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe për të përcaktuar se çfarë përmirësimesh duhet të bëhen për sigurimin e objektit.

6.4 Sigurimi gjatë emergjencave ose rasteve të mundshme të paparashikuara

Në këtë seksion duhet të përmbliken masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren gjatë emergjencave jo të lidhura me sigurimin ose situata të tjera të paparashikuara për të siguruar ruajtjen e burimeve radioaktive në objekt.

Tekst shembull

Për aq sa është e mundur, pa rrezikuar sigurinë e personelit, në rast emergjence që nuk ka të bëjë me sigurimin, si, për shembull, rastet e zjarrit, të tërmetit, përmytjeve ose stuhive *[personeli i caktuar me akses në burimin radioaktiv]* do të sigurojë që të gjitha pajisjet e teleterapisë dhe brakiterapisë të sigurohen në mënyrë të përshtatshme dhe që dyert e dhomave të trajtimit janë të mbyllura.

6.5 Rritja e nivelit të kërcënimit

Në këtë seksion duhet të përshkruhet mënyra se si trajtohen njoftimet për nivelin e kuq të shkallës së kërcënimit.

Me rritjen e shkallës së kërcënimit në nivel kombëtar ose lokal, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me institucionet e linjave përkatëse përcakton masat shtesë për përdoruesit e burimeve radioaktive sic ato e shohin të nevojshme. Këto masa janë të detyrueshme për zbatim nga ana e përdoruesve.

Tekst shembull

Në përputhje me VKM Nr.877 datë 30.10.2015 për miratimin e rregullores "Për sigurimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, neni 14 *[neni i ligjeve/rregulloreve në fuqi]*, kur objekti vihet në dijeni të një niveli të rritur kërcënimi (shih pjesën 4.1), *[personi përgjegjës për sigurimin, ose një pozicion tjetër i caktuar]* do të përcaktojë se çfarë hapash të menjëhershëm mund të ndërmerren për të rritur sigurimin për t'iu përgjigjur këtij niveli të rritur kërcënimi. Masat e menjëhershme mund të përfshijnë vendosjen e rojeve shtesë të sigurimit, ndryshimin e kodeve kryesore, njoftimin e stafit për rreziqe shtesë, testimin e pajisjeve të sigurimit dhe takimet me policinë lokale për të zhvilluar dhe rishikuar planet e reagimit/përgjigjes. Modifikimi i sistemit të sigurimit do të konsiderohet si i domosdoshëm, si, për shembull, instalimi i kamerave shtesë të sigurimit, brava të reja/shtesë, sisteme të reja/shtesë alarmi, ose masa të tjera, të tilla si

ndryshimet strukturore në objekt për të siguruar më mirë burimet. Nëse mendohet e nevojshme, masat duhet të miratohen sa më shpejt që të jetë e mundur.

Referencat

Listoni çdo dokument referimi, të tilla si rregulloret specifike, licencat rregullatore, manualët e operimit ose politikat dhe manualët organizative që përmenden në planin e sigurimit, ose që janë të nevojshme për të shpjeguar ose zgjeruar çdo hollësi në plan.

Shtojcat

Ofroni ose listoni procedurat e përmendura në planin e sigurimit, të tilla si procedurat në seksionin 5, duke përfshirë datat dhe versionin e tyre aktual.